



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. contact@pallatirinise.com

www. pallatirinise.com

Nr. 41375 Dt. 22.11.2024

Në bazë të nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 26, paragrafi 26.3 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe si dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 8.3 të Statutit të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë i emëruar nga Komisioni i aksionareve të Komunës së Prishtinës, si pronare në mbledhjen e mbajtur me datën 21.11.2024, e miraton këtë:

ANEKS NË RREGULLOREN

Për Pensionim të Parakohshëm të Punëtorëve në N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Neni 1.

Ndryshohet neni 5, paragrafi 2 i Rregullores Për Pensionim të Parakohshëm të Punëtorëve në N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A, datë 09.07.2024 nr. 1/773, ashtu që fshihet teksti:

"2. Pensioni i parakohshëm i punonjësit sipas paragrafit 1 të nenit 5, mund të bëhet vetëm nëse punonjësi është jo më shumë se dy (2) vjet para moshës së pensionimit".

Ndërsa në vend të tij shkruhet ky tekst i ri:

"2. Pensioni i parakohshëm i punonjësit sipas paragrafit 1 të nenit 5, mund të bëhet vetëm nëse punonjësi është jo më shumë se tri (3) vjet para moshës së pensionimit".

Neni 2.

Të gjitha dispozitat tjera të Rregullores Për Pensionim të Parakohshëm të Punëtorëve në N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A, datë 09.07.2024 nr. 1/773, mbesin në fuqi.

Neni 3.

Këto Plotësime të Rregullores, hynë në fuqi në ditën e miratimit dhe janë pjesë përbërëse e Rregullores Për Pensionim të Parakohshëm të Punëtorëve në N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A, datë 09.07.2024 nr. 1/773.

Kjo Aneks Rregullore aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. –Prishtinë, me datë 21.11.2024.

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. –Prishtinë

APROVUAR:

Bordi i Drejtorëve:

Ariana Pireva – Kryetare

Vjosa Rrahmani –Anëtare

Gani Sopi– Anëtar

Shuajb Mehmeti – Anëtar

